# KONTRATE THEMELIMI
# E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
# "BORSHI" SH.P.K.

Me ortak te vetem zotin Florjan Borshi .

Neni 1

Ortaku i vetem vendosi te krijoje shoqerine me pergjegjesi te kufizuar me emrin "Borshi" SH?P.K.

Neni 2

Objekti i shoqerise eshte ndertime te zakonshme te kategorise se pare, ndertime civile,industriale,turistike,bujqesore,ndertime te kategorise se dyte,punime restaurimi te kategorise se trete,ndertime dheu,murature betonimi,beton arme,tregtimin e mallrave e materialeve per ndertim si dhe tregtimin e mallrave te tjere me shumice e pakice eksport import.

Neni 3

Selia ligjore dhe administrative e shoqerise eshte ne Shkoder.Adresa lagja "Manush Alimani", rruga "Vasil Shanto",Nr.1144.

Neni 4

Kohezgjatja e shoqerise percaktohet nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar me afat 10 vjet dhe zgjatet ky afat me vendim te ortakut te vetem.

Neni 5

Kapitali themeltar i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Borshi" esh 100000 leke.Kapitali themeltar eshte paguar ne degen e Bankes Kombet tregtare Shkoder me date 21.Qershor 1994 me Nr.llogarie 3361/116 me Nr.MA 314322,dokument qe i lidhet kesaj kontrate.

Neni 6

Shoqeria konsiderohet e krijuar ne perputhje me dispozitat e kesaj kontrate te statusit qe miratohet dhe firmoset nga ortaku i vetem dhe qe i lidhet kesaj kontrate si dhe legjislacionit shqiptar.

Neni 7

Ne perputhje me nenin 9 te statusit te shoqerise,themeluesi,ortaku i vetem do te administroje vete per periudhe kohe te pacaktuar

Neni 10

Viti i pare financiar dhe ekonomik mbyllet 31.12.1994.

Neni 11

Statusi i kesaj shoqerie eshte pjese perberese e kesaj kontrate.

Neni 12

Kjo kontrate themelimi perpilohet ne disa kopje per tu shperndare organeve kopetente, nje kopje mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Borshi" SH.P.K.

ORTAKU I VETEM I SHOQERIS ME PERGJEGJSI
TE KUFIZUAR
" B O R SH I " SH.P.K.

# S T A T U S

## I veprimtarise se Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar

## "B O R SH I" SH.P.K.

### EMERTIMI I SHOQERISE

**Neni 1**

Shoqeria emertohet shoqeri me pergjegjesi te kufizuar "Borshi"SH.P.K. me ortak te vetem Z.Florijan Borshi ,me banim ne Shkoder.

**Neni 2**

Selia e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Borshi" SH.P.K.ndodhet ne qytetin e Shkodres.

**Neni 3**

Kohezgjatja e shoqerise me pergjegjesi te kufizugr "Borshi"eshte 10 vjet.Ajo mund te zgjatet ose prishet me vendim te ortakut te vetem.

**Neni 4**

Objekti, i veprimtarise te kesaj shoqerie eshte : ndertime te zakonshme te kategorise se pare,ndertime civile,industriale,bujqesore,turistike,ndertime te kadegorise se dyte,pynime restaurimi te kadegorise se trete,ndertime dheu,murature,betonim,beton arme,tregtimin e mallrave e materialeve te ndertimit si dhe tregtimin e mallrave te tjere me shumice e pakice eksport import.

**Neni 5**

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuqr "Borshi" SH.P.K. mund te ndryshoje emrin,seline,objektin,sipas vendimeve qe do te marre ortaku i vetem zoti Florjan Borshi.

**Neni 6**

Shoqeria ka kapital themeltar 100000 leke i cili perbehet nga kontributi i Z.Florjan Borshi dhe percaktohet nga ljetet themelore ete tjera te nevojshme per veprimtarine e shoqerise dhe depozitohet ne degen e bankes Kombetare tregtare Shkoder,ku do te çelet llogaria perkatese.Ne librin e llogarise se shoqerise krijohet fondi themelor ku shenohet kapitali i vene per shoqerine.

**Neni 7**

Fitimi i realizuar i shoqerise pas shlyerjes se detyrimeve ligjore dhe pas zbritjeve te fondeve te tjera do ti nenshtrohet nje takse qe percakto-n organi kopetent ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

**Neni 8**

Veprimtaria e shoqerise zbrohet nga legjislacioni ne fuqi.

**Neni 9**

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "Borshi" SH.P.K. ka ortak te vetem Z.Florjan Borshi i cili ka te drejte te perfaqsoje shoqerine ne maredheniet e saj me shtetin si dhe me te tjere (te lidhe mareveshje,kontrata, te kryeje veprime financiare etj) organizon dhe drejton te gjithe veprimtarine e shoqerise ne baze te statusit dhe kontrates se lidhur. Z.Florjan Borshi mund te caktoje administratorete te cilet emerohen nga ortaku i

vetem dhe mund te kryejne te gjitha veprimet ne interes te shoqerise dhe veprojne ne baze te prokures dhe autorizimit te dhene nga ortaku i vetem. Per kontratat dhe veprimet e tjera juridike e financiare qe kryen administratori eshe pergjegjes vete ai. Ortaku i vetem kur shikon se administratori ka vepruar ne kundershtim me interesat e shoqerise çfuqizon veprimet e tij duke i quajtur ato te pavlevshme.

Neni 10

Per problemet organizative,ekonomike e financiare vendimet e marra nga ortaku i vetem jane te zbatushme per te gjithe personat e punesuar ne shoqeri.

Neni 11

SH.P.K. "Borshi" deklarohet e krijuar dhe vepron si person juridik nga dita e regjistrimit ne regjistrin tregtar ne gjykaten e Tiranes dhe pasi kam marre lejen nga organi financiar.

Neni 12

Veprimtaria e shoqerise realizohet ne baze te leverdise ekosomike dhe pasqyrohet ne bilancin e saj,pergjigjet per detyrimet qe ka ajo.

Neni 13

Shoqeria pushon veprimtarine e saj pasi shlyen te gjitha detyrimet qe ka ajo. largimi nga puna i personave te punesuar ne shoqeri behet me vendimin e ortakut te vetem dhe kerkesen qe ben personi qe deshiron te largohet,duke e bere kete kerkese 30 dite perpare dates se largimit.

Neni 14

Maredheniet ne pune rregullohen sipas kontrates se punes.Mosmareveshjet qe lindin ne rastin e largimit nga puna ose ne maredheniet e pu-nes me ortakun e vetem ose me te tjeret,zgjidhen ne rruge ligjore.

Neni 15

Ortaku i vetem ka te drejte te organizoje mbledhje te zakonshme dhe te jashte-ezakonshme me administraten dhe punonjesit per probleme te tilla si : shtesa ne status,transferim kapitali,transferim te selise,zgjerim kapitali, dhe per ndryshimin e llojit te shoqerise qe eshte krijuar.

Neni 16

Viti financiar i shoqerise fillon ne fillimin e çdo viti kalendarik,perveç vitit te pare qe fillon me fillimin e aktivitetit te shoqerise pasi miratohe-t si subjekt juridik.

Neni 17

Forma e bilanceve dhe e llogarive ekonomike te shoqerise percaktohet nga ortaku i vetem dhe administratori qe ka per detyre te beje bilancin 3,6 dhe 12 mujor.Miratimi perfundimtar per bilancin e jep ortaku i vetem i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Borshi " SH.P.K.

## DISPOZITA TE PERGJITHSIME

### Neni 18

Per ato nuk eshte shprehur plotesisht ne kete status i referohet plotesimeve qe do te beje ortaku i vetem si dhe me ligjet te veçanta ne fuqi, konkretisht te ligjit Nr.7638 date 19.11.1992. Ndryshimet dhe plotesimet ne kete status do te behen ne te njejten menyre dhe proçedure ne te cilin eshte ngjere ky status. Statusi nenshkruhet regullisht nga ortaku i vetem i shoqerise me pergjegjesi te kufizuqr "Borshi" SH.P.K.

ORTAKU I VETEM
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"B O R SH I" SH.P.K.
Florjan Borshi
Florjan

REPUPLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
NOTERIA TIRANE

Nr. 5504. Rep
Nr. 3787. Kol

## Vertetim

Sot me date 24-06-94 u paraqit ne zyren e noterise Tirane Z.Florjan Borshi i biri i Qazimit dhe i Fejzies i datelindjes 1961 banues ne qytetin e Shkodres per indentitetin e te cilit u sigurova nepermjet leternjoftimit te tij personal, madhor me zotesi te plote juridike per sa me siper eshte statusi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Borshi" SH.P.K. qe e ka formuar si ortak i vetem, akte keto te redaktuara jashte kesaj zyre per me vullnetin e lire e te plote te tij qe i nenshkruan ato rregullisht perpara meje, ndersa une noteria vertetoj ato sipas ligjit.

NOTERE